

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **UNIVERSITETI HAXHI ZEKA NË PEJË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **208/97400-26-5357-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Ritender-Furnizim me material promovues zyrtar për nevojat e UHZ-së**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	AGIMI DE SH.P.K.
NUI	812243088
Adresa	Sheshi Mentor Tolaj
Vendi	DEÇAN
Kodi postar	51000
Numri Telefonit	044/635635
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Hajrije Selmanaj
Adresa elektronike	agimide.print@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	16.07.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Ritender-Furnizim me material promovues zyrtar për nevojat e UHZ-së
Njoftimi

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kerkese per ri-shqyrtim kemi parashtruar me 10.07.2026.

Vendimin per refuzimin e kerkeses per ri-shqyrtim e kemi pranuar me 14.07.2026.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1- Qellimi

Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Neni 27- Dosja e Tenderit
Neni 60- Kriteret per dhenie te kontrates
Neni 69- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 70- Standartet per sigurimin e cilesise
Neni 108/A- Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjabë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Ne si OE që jemi të interesuar për marrë pjesë në tenderin në fjalë, dhe pretendojmë se janë shkelur dispozita kryesore të ligjit të Prokurimit publik, konkretisht paragrafi 1 i nenit 1 dhe paragrafi 1 i nenit 2 të LPP-së, ku kërkohet që gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, të zhvillohen procedura në mënyrë efikase, transparente, të drejta dhe konkurruese!

Nëse shiqojmë me kujdes “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale” tek kapaciteti teknik dhe profesional, vërejmë qartë se kërkesat e vendosura shkelin Nenin 7 të LPP-së, në të cilin kërkohet Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi. Kërkesat e vendosura janë në kundërshtim me këtë nen!

Bazuar në kërkesat si në dosje të tenderit ne vlerësojmë se ju si AK, me konkretisht Njësi kërkuese me vendosjen e kërkesave të pershtatshmeris profesionale konkretisht tek stafi profesional nuk ka vepruar bazuar në LPP dhe rregullore në fuqi!

Të gjitha aktet legjislative primare dhe sekondare të Prokurimit Publik, e ndalojnë përgaditjen e DT, që në një mënyrë apo tjetër e favorizon ose diskriminon kundër një ose më shumë OE potencial.

Përdorimi i çfardo kriteri nga ana e Autoriteteve Kontraktuese që është diskriminues për OE është kriter jo-ligjor.

Pra, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledhë sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose

diskriminojë

kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

Ne konstatojm se një kriter i vendosur nga AK-ja ishte diskriminues dhe në kundërshtim me nenet 7 të Ligjit

për Prokurimin Publik, sepse kufizonte pa nevojë konkurrencën.

Po ashtu edhe neni 4 i RRPP-së paragrafi 4.3 nen a),b), dhe nen c).

Më poshtë po paraqesim pretendimet tona:

Pretendimi nr.1:

Ju keni kërkuar:

9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Operatori Ekonomik duhet të ofroj stafin e nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt.

1.OE

duhet të ketë një Puntorë i cili duhet të jetë i certifikuar nga MAPL per Menaxhim te Projekteve. I

certifikuar sipas standarditi 45001 2018, dhe te kete pervojë pune minimum 10 vite.

Vendimi per

caktim te projekt menxherit. 2.OE duhet të ketë një puntore me minimum 5 vite provoj të punes, i

cili duhet të jetë i certifikuar sipas standardit F5 Certified Administrator

Një pasqyrë tabelare e personelit dhe puntorve të angazhuar me kontratë ose parakontratës duke

saktësuar emrin, mbiemrin, kontaktin profesionin, eksperiencia dhe pozita e angazhimit në kompani,

duhet të dorzohet original e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Vendimi me shkrim për caktimin e

menaaxherit te projektit. Për ingjinjerët në pozicionin duhet diploma, kontrata e punës, CV e

nënshkruar nga ingjineri dhe vertetimin mbi provojen e punes. Në rast të marveshjes për projekt

(kontratës apo parakontrates për projekt) duhet të jetë e nenshkuar nga të dyja palët.

Kërkesat e përcaktuara për kapacitetin teknik dhe profesional, përkatësisht ato që lidhen me stafin

profesional dhe pajisjet/makineritë, i konsiderojmë të panevojshme, joproporcionale dhe jo në përputhje me

dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës,

përkatësisht nenet 69 dhe

70, të cilat kërkojnë që kriteret e kualifikimit të jenë proporcionale, relevante dhe të lidhura ngushtë me

objektin e kontratës.

Duke qenë se kompania jonë ka qenë kontraktore e këtij Autoriteti Kontraktues për një periudhë të gjatë për

furnizime të së njëjtës natyrë, kemi njohuri të plota mbi kërkesat dhe mënyrën e realizimit të këtij projekti.

Bazuar në këtë përvojë, vlerësojmë se kriteret e vendosura nuk janë të domosdoshme për realizimin e suksesshëm të kontratës dhe kufizojnë pa nevojë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Kompania jonë ka mbi dy dekada përvojë në shtyp, dizajnim grafik dhe furnizim me materiale të kësaj natyre, si dhe ka realizuar me sukses dhjetëra kontrata të ngjashme për institucione publike dhe private.

Gjatë gjithë kësaj periudhe, asnjëherë nuk janë kërkuar kritere të tilla si posedimi i stafit të certifikuar nga MAPL për menaxhim projektesh, certifikime sipas standardit ISO 45001:2018 apo certifikime F5 Certified Administrator, pasi këto nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Objekti i kësaj kontrate nuk përfshin furnizimin, instalimin apo mirëmbajtjen e pajisjeve apo sistemeve informatike që do të justifikonin kërkesën për një administrator të certifikuar F5 Certified Administrator.

Gjithashtu, nuk përfshin aktivitete që kërkojnë angazhimin e një Menaxheri të Projektit të certifikuar nga MAPL apo sipas standardit ISO 45001:2018. Për natyrën e këtij projekti, personeli profesional i nevojshëm është ai që lidhet drejtpërdrejt me dizajnin grafik, përgatitjen dhe realizimin e materialeve të kërkuara, siç është paraparë edhe në kriteret e tjera të dosjes së tenderit.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se këto kërkesa nuk janë relevante me objektin e kontratës, nuk janë proporcionale me kompleksitetin e projektit dhe krijojnë barriera të panevojshme për operatorët ekonomikë që kanë kapacitet dhe përvojë të dëshmuar në këtë fushë.

Për më tepër, vendosja e kriterëve që nuk lidhen drejtpërdrejt me objektin e kontratës është në kundërshtim me parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik, veçanërisht me nenin 1, i cili synon të sigurojë përdorimin efikas, ekonomik dhe transparent të fondeve publike, si dhe trajtim të barabartë dhe konkurrencë efektive ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Duke marrë parasysh sa më sipër, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të rishqyrtojë dhe të largojë këto kërkesa nga dosja e tenderit ose t'i zëvendësojë ato me kritere që janë objektivisht të justifikuara, proporcionale dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës, në mënyrë që të sigurohet konkurrencë e drejtë dhe trajtim i barabartë i të gjithë operatorëve ekonomikë, në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Pretendimi nr.2:

Operatori Ekonomik duhet të ofroj stafin e nevojshëm që do të angazhohet në këtë projekt.

1.Teknik i makineris 1 (nje) 2.Nje Puntor te certifikuar per operim me CNC makina 3.Nje puntore te certifikuar per Dizajn Grafik - Bachelor profesional ne produksion medial – Niveli gjashte i kualifikimit sipas Kornizes Kombetare te Kualifikimeve KKK KEK 4.Kater puntore te trajnuar me Siguri dhe shendet ne pune si dhe te certifikuar per mbrojtje nga zjarri.

Deshmia; Kerkohet kontrata e punes ose parakontrata per projektin se bashku me CV e nenshkruar nga vete personi, Referencat e punes. Certifikatat ose diplomat e kerkuara kopje

OE duhet të posedojë pajisje teknike të nevojshme 1.Platform me strukture rrotullimi 90 shkalle qe arrin lartesisin deri 15m 2.Uv printer per plastike, akril, dru, metal, xham, lekurë 3.Makine automatike per lakim te profileve te aluminit me gjerësi 25 – 160 mm 4.Makine CNC partner per prerjen dhe gravimin e materialeve. Dru, plastike,metal deri 0.5mm Shpejtsia e prerjes 8 metra minute, raft helikodial dhe bosht pinioni 1.5 module Kombi per transportin e materialeve deri 3.5 ton.

Po ashtu, kërkesat lidhur me pajisjet teknike që duhet t'i posedojë Operatori Ekonomik, përkatësisht:

? platformë me strukturë rrotullimi 90° që arrin lartësi deri në 15 metra;
? UV printer për shtypje në plastikë, akril, dru, metal, xham dhe lëkurë;
? makinë automatike për lakimin e profileve të aluminit me gjerësi 25–160 mm;
? makinë CNC për prerjen dhe gravimin e materialeve (dru, plastikë dhe metal), me karakteristikat teknike të specifikuara në dosjen e tenderit;
i konsiderojmë kritere të panevojshme, joproporcionale dhe të palidhura me objektin e aktivitetit të

prokurimit, në kundërshtim me nenet 69 dhe 70 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, të cilat kërkojnë që kriteret e kualifikimit të jenë relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës.

Objekti i këtij aktiviteti të prokurimit ka të bëjë me dizajnimin dhe furnizimin me materiale promovuese, siç janë stilolapsat, gotat, fasciklat, USB-të, varëset për ID kartela, power bank, notesa dhe produkte të ngjashme. Për realizimin e këtyre furnizimeve nuk është e nevojshme që operatori ekonomik të posedojë pajisjet e lartcekura, pasi një pjesë e konsiderueshme e këtyre produkteve prodhohen nga prodhues të specializuar dhe operatorët ekonomikë realizojnë kontratat përmes furnizimit dhe personalizimit të produkteve, pa qenë e domosdoshme posedimi i të gjitha makinerive të kërkuara. Për më tepër, specifikimi i karakteristikave shumë të detajuara teknike të pajisjeve kufizon pa nevojë konkurrencën dhe bie ndesh me parimet e trajtimit të barabartë, proporcionalitetit dhe konkurrencës efektive të përcaktuara në nenin 1 të Ligjit për Prokurimin Publik. Autoriteti Kontraktues duhet të vendosë vetëm ato kërkesa që janë objektivist të nevojshme për realizimin e kontratës dhe jo kritere që kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë pa një arsyetim të bazuar.

Rrjedhimisht, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që të rishikojë dhe korrigjojë dosjen e tenderit, duke larguar ose duke modifikuar këto kritere në mënyrë që ato të jenë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe të mundësojnë konkurrencë të drejtë dhe efektive ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Një konkurrencë më e gjerë është gjithashtu në interes të vetë Autoritetit Kontraktues, pasi rrit numrin e ofertuesve potencialë, siguron konkurrencë reale dhe krijon mundësi për pranimin e ofertave ekonomikisht më të favorshme, duke garantuar shfrytëzim sa më efikas dhe racional të fondeve publike, në përputhje me nenin 1 të Ligjit për Prokurimin Publik.

Shpresojmë që kërkesa jonë të merret në konsideratë dhe të bëhen ndryshimet e nevojshme në dosjen e tenderit. Në të kundërtën, do të jemi të detyruar të ushtrojmë të drejtat tona ligjore, në përputhje me nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik, duke paraqitur kërkesë për rishqyrtim dhe duke ndjekur procedurat e parapara me legjislacionin në fuqi.

Për më tepër, Operatori Ekonomik ynë ka qenë kontraktues i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë për realizimin e shërbimeve dhe furnizimeve të kësaj natyre gjatë tre (3) viteve të fundit. Bazuar në këtë përvojë të drejtpërdrejtë, kemi njohuri të plota mbi kërkesat reale të Autoritetit Kontraktues, procesin e realizimit të

kontratës dhe kapacitetet teknike e profesionale që nevojiten për përmbushjen me sukses të obligimeve kontraktuale.

Gjatë kësaj periudhe, të gjitha kontratat janë realizuar në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktues, pa qenë e nevojshme posedimi i pajisjeve dhe kapaciteteve teknike që kërkohen në këtë procedurë të prokurimit. Për këtë arsye, konsiderojmë se kërkesat aktuale nuk pasqyrojnë nevojat reale të kontratës dhe nuk janë proporcionale me objektin e aktivitetit të prokurimit, duke krijuar kufizime të panevojshme për operatorët ekonomikë që kanë përvojë dhe kapacitet të dëshmuar në këtë fushë.

Përgjigjeja e AK-se:

Përgjigjja

Kërkesa mbetet si në dosje të tenderit.

Të nderuar, ne vlerëojmë se sipas pretendimeve janë vendosur kritere diskriminuese, të cilat duhet të ndryshohen/largohen.

Bazuar në pretendimet e cekura më lartë ne si OE kërkojmë nga ju si AK që bazë të LPP-së dhe

7/3

rregulloreve në fuqi, për prokurim publik, të APROVONI si të bazuar kërkesën tonë për rishqyrtim, të

ndryshoni DT konkretisht “Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale” sipas kërkesës tonë,

me të vetmin qëllim që ky projekt të realizohet në menyrën më profesionale dhe duke u bazuar edhe në

Ligj!

Në të kundërtën, ne jemi të detyruar që bazuar në ligjin e LPP-së, të kërkojmë të drejtën tonë në

instanca më të larta.

AK ka refuzuar kërkesën për ri-shqyrtim si të pabazuar dhe nuk ka bërë ndryshimet e nevojshme në dosjen e tenderit, më 14.07. kemi pranuar përgjigjen/refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim dhe megjithatë keshille juridike është paraqitur që të ankohejmë në OSHP brenda afatit 10 ditë, AK nuk ka ndryshuar/ zgjidhur afatin për ofertim në këtë mënyrë ka shkelur nenin 108/a të LPP-së.

Ne kemi ofruar argumente të mjaftueshme se kriteret e përcaktuara janë jo relevante me natyrën e aktivitetit të prokurimit si dhe diskriminojnë të gjithë OE të interesuar për pjesëmarrje në këtë aktivitet të prokurimit prandaj kërkojmë nga Organi shqyrtues i prokurimit që të aprovojë si të bazuar ankesën e kompanisë sonë dhe të detyrohet zyra e prokurimit pranë UHZ që të bëjë ndryshimet e nevojshme në dosjen e tenderit dhe kriteret të hartohen konform dispozitave ligjore të LPP-së duke pasur parasysh nenin 1 dhe 6 qëllimi i këtij ligji është që fondet publike të shfrytëzohen në formë sa më të racionalë dhe ekonomike.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ne kete faze nuk kemi dëme materiale përveq përgaditjes së ankesës dhe kërkesës për ri-shqyrtim mirepo formën si është përgaditur dosja na pamundëson ofertimin për këtë aktivitet të prokurimit dhe fitimin e paramenduar nga ky projekt, favorizimi i AK për OE të caktuar përkatësisht pershtatja e kriterëve dhe kërkesave në dosjen e tenderit demton buxhetin publik përkatësisht Universitetit Haxhi Zeka pasi që shumë OE potencial të cilët mund të kryejnë këto furnizime & shërbime e kanë të pamundur të ofertojnë për shkak të kriterëve diskriminuesë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkëngjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*